

Prof. Dr. Marenglen VERLI

**SITUATA NË TREVAT SHQIPTARE LINDORE
TË PUSHTUARA DHE QËNDRESA ANTISERBE
(tetor 1912 – shtator 1913)***

Ende sot, 90 vjet pas kryengritjes së fuqishme antiserbe të vjeshtës së vitit 1919, që u shtri nga viset përreth liqeneve të Ohrit e të Prespës deri në Malësinë e Gjakovës e në Drenicë dhe që pati përmasa, e ndoshta rrjedhoja të tilla sa të quhet simbolikisht aty-këtu edhe “Lufta e Tretë Ballkanike”; **ende sot**, pasi kemi diskutuar disa herë në tubime shkencore për këtë ngjarje të rëndësishme të historisë, që i kapërcen përmasat lokale, madje edhe kombëtare; **ende sot**, pasi janë hulumtuar mjaft arkiva, bibliografi e memoare dhe i kemi lënë asaj mjaft vend në studime të ndryshme shkencore,¹ **ende sot** ne përsëri kemi arsye e dëshirë t’i rikthehemi përkujtimit dhe trajtimit shkencor të kësaj ngjarjeje të spikatur të historisë sonë kombëtare, madje jo vetëm për homazh por edhe për të vazhduar t’u qasemi më pranë të njohurave dhe të panjohurave të 90 vjetëve më parë.

Përse shpërtheu kryengritja e shtatorit të vitit 1913? A ishte e organizuar dhe e programuar çdo gjë në këtë kryengritje, apo ajo qe pasojë e provokimit të qëllimshëm të Serbisë, për t’u dhënë në një moment të përshtatshëm për të, një goditje dërrmuese shqiptarëve të mellfosur nga regjimi i dhunshëm disamujor serb i pushtimit? Cili ishte roli i Qeverisë së Vlorës në këtë kryengritje? A kishte ndikim Sofja në ngjarjet e shtatorit 1913? Po Esat Toptani a kishte rol në këtë ngjarje? Mund të bëhen edhe pyetje të tjera, që natyrisht kërkojnë përgjigje të argumentuara.

Studiues e autorë të ndryshëm deri sot kanë shfaqur pikëpamje, ose kanë dhënë përgjigje të ndryshme për pyetjet e mësipërme. Ndoshta kështu do të

* Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore kushtuar 90-vjetorit të Kryengritjes së Shtatorit 1913, Strugë, 4 tetor 2003.

¹ Këtë ngjarje historike e kanë trajtuar prof.dr. Thoma Murzaku, prof.dr. Kristaq Prifti, dr. Halim Purellku, prof.dr. Gazmend Shpuza, dr. Fejzulla Shabani, prof.dr. Limon Rushiti, dr. Nebi Dervishi, dr. Reshat Nexhipi etj.

ndodhë edhe më tej, pavarësisht se studiuesit pjesëmarrës në këtë konferencë shkencore do të sjellin risi faktologjike e analitike për tematikën në fjalë.

Pavarësisht nga problemet e diskutueshme që lidhen me kryengritjen e vjeshtës së vitit 1913, e rëndësishme është se për të vijojmë të studiojmë, të sjellim fakte e argumente të reja, për realitetin e asaj kohe. Kjo natyrisht vlen jo vetëm për skrupulozitet shkencor, por edhe për t'i shërbyer të sotmes (madje kjo ka shumë rëndësi) me përvojën e së kaluarës, duke asimiluar mësimet apo mesazhet që na përcjell historia.

Me një dëshirë të tillë, përmes *vështrimit të situatës në trevat shqiptare lindore të pushtuara dhe qëndresës antiserbe në periudhën tetor 1912 – shtator 1913*, do të desha të jap opinionin tim për problemin më thelbësor të kryengritjes së 1913-ës: *Përse shqiptarët u ngritën masivisht kundër serbëve pikërisht në shtatorin e atij viti?*

Dihet se menjëherë, ose shumë shpejt pas shpërthimit të Luftës së Parë Ballkanike* armatat e Aleancës i shpartalluan keqazi trupat osmane, thyen edhe rezistencën vetëmbrojtëse të shqiptarëve dhe për më pak se dy muaj pushtuan gati gjithë “trashëgimninë” osmane në Ballkan, me përjashtim të disa qyteteve të fortifikuara dhe të disa rajoneve të mbetur si xhepa, që përsa u përket viseve qytetare ishin përkatësisht Shkodra e Janina dhe viset përreth Vlorës, apo krahina e Matit.²

Armëpushimi midis aleatëve dhe Turqisë, i 3 dhjetorit 1912, e gjeti ushtrinë serbe pushtuese në pothuaj të gjithë viset shqiptare, nga Mitrovica e Prishtina në veri, deri në Shkup, Kumanovë e Manastir, Strugë, Elbasan e Durrës, përkatësisht në të gjithë territorin në veri të vijës Durrës-Manastir.³

Dy muajt e luftës së shpejtë të aleatëve,⁴ të pasuar nga dy muaj të një armëpushimi mjaft të pa respektuar, që u ndërpre më 3 shkurt 1913 për t'u pasuar nga katër muaj të tjerë lufte, mjaftuan për ta shembur përfundimisht

* Më 8 tetor luftën e filloi Mali i Zi, më 17 tetor atë e pasuan Serbia e Bullgaria dhe më 18 tetor edhe Greqia.

² *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, Tiranë, 1984, f. 490-492; etj.

³ L. Rushiti, *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918*, Prishtinë, 1986, f. 35; Th. Murzaku, *Politika e Serbisë kundrejt Shqipërisë gjatë Luftës Ballkanike 1912-1913*, Tiranë, 1987; etj. Më 24 tetor ra Kumanova, më 25 tetor u dorëzua pa luftë Shkupi, më 30 tetor Tetova, më 2 nëntor Gostivari, më 5 nëntor ra Kërçova dhe Përlepi, më 19 tetor u pushtua Manastiri dhe më 29 nëntor, pas Lezhës më 21, Krujës më 25, Elbasanit më 26 dhe Tiranës më 28, kishte rënë edhe Dibra.

⁴ *Po aty*; Shih edhe: H. Purellku, *Raprezaljet e pushtetit serb ndaj shqiptarëve të Maqedonisë së sotme (1912-1915)*, në “Jehona”, nr.4, Shkup, 1992, f. 108. Deri më 19 dhjetor 1912, divizioni i dytë i Moravës i ushtrisë serbe, që operonte në trevat e Tetovës, Gostivarit, Kërçovës, Dibrës, Strugës, Ohrit, Pogradecit dhe Elbasanit, i kishte përfunduar operacionet luftarake.

Perandorinë Osmane.⁵ Por paqja e 30 majit, e cila shënoi fundin e Luftës së Parë Ballkanike, pas një muaji do të davaritej prej Luftës së Dytë Ballkanike (që dëshmoi brishtësinë dhe amoralitetin e Aleancës), këtë herë midis vetë aleatëve, me ç'rast kundër Bullgarisë u hodhën gjithë të tjerët, madje edhe Perandoria Osmane e porsashpartalluar. Dyzet ditë më pas, më 10 gusht 1913, Bullgaria u gjunjëzua.⁶ Dhe pikërisht dyzet ditë të tjera më pas, më 21 shtator, do të shpërthente kryengritja e fuqishme shqiptare me epiqendër në Dibër, e cila është objekt i këtij sesiioni shkencor.

Gjatë gjithë harkut kohor prej rreth 10-11 muajsh (tetor 1912 – shtator 1913), pavarësisht nga kthesat që merrnin ngjarjet, shqiptarët e trevave lindore (dhe natyrisht jo vetëm ata) e panë vehten me shpatulla në tokë, çka natyrisht e bënte të pritshëm reagimin apo tentimin e tyre për të dalë nga ky pozicion i vështirë asfiksues. Ndonëse kishin kontribuar ndjeshëm për asgjësimin e sundimit osman në Ballkan, madje ndonëse kishin marrë premtimin e hapur mbretëror të kraljit serb Petar Karagjeorgjeviç, përmes proklamatës së 17 tetorit 1912, në prag të Luftës së Parë Ballkanike, se ushtria serbe do të sillte për të gjithë “lirinë, vëllazërinë, barazinë”, si edhe “paqen dhe përparimin e dëshiruar”,⁷ shqiptarët u konsideruan pa dallim armiq, njësoj si turqit dhe po ashtu u luftuan. Me pretekste të ndryshme, në shërbim të synimeve (tashmë të njohura) për copëtimin, aneksimin dhe përjetësimin e sundimit në viset shqiptare, qarqet drejtuese të Serbisë (sikurse dhe ato të gjithë shteteve të tjera të Aleancës) në viset ku shkelën e në këtë kuadër edhe në viset shqiptare lindore, ligjëruan dhe ushtruan terrorin më të pashembullt, si edhe praktikuan të gjitha format e dhunës e të presionit që mund të imagjinohen.⁸ Kjo politikë dhe praktikë barbare u linte shqiptarëve vetëm dy alternativa, nënshtrimin dhe asimilimin, ose asgjësimin dhe shpërnguljen, çka në perspektivë do të thoshte shkombëtarizim dhe sllavizim (në mos serbizim) i viseve të tyre.

Vrasja dhe masakrimi i mijëra civilëve shqiptarë vetëm gjatë periudhës tetor-nëntor 1912, kur ende zhvilloheshin veprime ushtarake në front dhe kryheshin operacione të përditshme spastrimi, është fakt i njohur. Për këtë

⁵ *Historia e Shqipërisë*, vëll. III, Tiranë, 1984, f. 671; etj. Në mars-prill 1913 ranë Janina në duart e grekëve dhe Shkodra në duart e malazezëve. Trupat serbe ndërkohë ishin të pranishme jo vetëm në Shkodër, përkrah malazezëve por edhe deri në Edirne, pranë bullgarëve me dy batalione, simbol solidariteti.

⁶ Xh. Shala, *Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1912-1918*, Prishtinë, 1990, f. 65; L. Rushiti, *vep. e përm.*, f. 42; etj.

⁷ Th. Murzaku, *vep. e përm.*, f. 126.

⁸ *Po ary*; Shih edhe: Sh. Braha, *Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare 1844-1930*, Tiranë, 1992; H. Purellku, *art. i përm.*, në “Jehona”, nr. 4, Shkup, 1992, f. 114; etj.

terror të përmasave të pabesueshme, ekzistojnë dëshmi rrëqethëse, të dhëna nga vëzhgues të besueshëm perëndimorë, konsuj, gazetarë dhe shumë dëshmitarë të tjerë okularë, duke përfshirë madje edhe ushtarë e oficerë serbë, si edhe publicistë apo personalitete të socialdemokracisë serbe.⁹ Ata japin të dhëna të shumta për “gjahun” e padëgjuar mbi shqiptarët në ikje, që kryenin soldateska serbe dhe bandat çetnike në shërbim të saj, gjah njerëzor si ai që konkuistadorët bënë dikur në kontinentin e ri, që e çoi numrin e të masakruarve **vetëm** gjatë muajit të parë të luftës dhe **vetëm** në Vilajetin e Kosovës, në mbi 8 mijë vetë, pa dallim moshe e gjinie. Prej tyre rreth 3 mijë vetë u likuiduan vetëm në zonën midis Kumanovës dhe Shkupit.¹⁰ Disa muaj më pas, më 22 mars 1913, gazeta “Radničke Novine” e socialdemokracisë serbe, do të pohonte se periudha që nga tetori i vitit 1912, ishte një vit shfarosjeje sistematike i popullsisë shqiptare në të gjitha trevat e pushtuara nga ushtria serbe, e cila e fanatizuar keqaz nga propaganda ultrashoviniste “i shfaroste shqiptarët ... me bindjen kriminale se me këtë po bënte një vepër kombëtare”.¹¹

Terrori dhe masakrat tepër të egra, veçanërisht në viset ku ndeshje rezistencë, të motivuara nga një propagandë intensive shovene, që shërbehej jo vetëm me argumente për nevojën e çarmatimit dhe vendosjen e rendit, por edhe me “argumente” etnike apo nacionale, fetare, social-ekonomike apo kulturore etj., u shoqëruan me shtrembërimin, djegien dhe grabitjen e shumë vendbanimeve, përkatësisht dhjetëra mijëra banesave dhe të një pasurie të pallogaritshme të grumbulluar me punën e shumë brezave. Drejtues ushtarakë të niveleve të ndryshme, në krye të forcave që komandonin, shkatërronin e plaçkisnin, pa kursyer as objektet e kultit dhe nisin drejt familjeve të tyre çdo gjë me vlerë, njësoj sikurse vojvodët e bandave çetnike.¹² Shqiptarët, veçanërisht elementi mysliman, por edhe ai i besimit

⁹ Po aty; Shih edhe: *AIH, HHStA, PA, A*. Raporte të përfaqësuesve austro-hungarezë në Beograd, Shkup etj., dërguar qeverisë në Vjenë gjatë nëntor-dhjetorit 1912; H. Stërmilli, *Dibra në prag të historisë*, Tiranë, 1940, f. 76; D. Tucoviq, *Srbija i Albanija*, Prishtinë, 1986 etj.

¹⁰ Gazeta “Liria e Shqipërisë”, 22 nëntor 1912, e cila citon shtypin evropian.

¹¹ *Dokumenti u spolnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914*, Knjiga V, VI, Beograd, 1981-1986; S. Martinoviq, *Qëndrimi i ushtrisë serbe ndaj shqiptarëve në viset e pushtuara në vitet 1912-1913*, në “Gjurmime Albanologjike” (seria e shkencave historike), nr.7, Prishtinë, 1972, f. 265. Citimi i dytë është marrë nga “Radničke Novine”, 22 tetor 1913.

¹² P. Stojanov, *Makedonija vo vreme na balkanskite vojni i prvrta svetska vojna 1912-1918*, Skopje, 1969, f. 185; Z. Cana, *Dimitrije Tucoviq (Koha dhe Vepra)*, Prishtinë, 1983, f. 217-218; F. Shabani, *vep. e përm.*, f. 142; Z. Cana, *Kosta Novakoviqi për Shqipërinë dhe invadimi nga Serbia*, në “Përparimi”, nr.1, Prishtinë, 1977, f. 105; etj.

katolik, për gjithë këtë lukuni të armatosur, me ose pa uniformë, ishin pa përjashtim armiq të që duheshin asgjësuar si kundërshtarë ushtarakë dhe si anëtarë të një kombi armik, mandej si besimtarë të një feje tjetër të papranueshme, por shpesh edhe të etiketuar si shtypës e shfrytëzues socialë të paradokohshëm, ose si konkurentë ekonomikë, të cilët duhej të shpronësoheshin e rrënoheshin në favor të fitimtarëve etj.

Në veprimet e këtij lloji të ushtrisë serbe ndaj shqiptarëve, diferencat kohore dhe gjeografike në intensitetin e dhunës, deri në qershorin e vitit 1913 diktoheshin vetëm nga situatat konkrete që sillte zhvillimi i veprimeve luftarake dhe largësia nga vija e frontit, por natyrisht dhe oshilacionet në koniunkturat ndërkombëtare, posaçërisht zhvillimet që ndodhnin në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, ku vendosej për të ardhmen e Ballkanit, si edhe problemet që shkaktoheshin nga rezistenca e popullsisë shqiptare.¹³

Pas kësaj, gjatë Luftës së Dytë Ballkanike, rënia e përkohshme e dhunës ndodhi për të mos krijuar probleme në prapavija, aq më tepër se gjatë kësaj periudhe dhe më pas pushtuesve serbë iu shtuan problemet edhe me popullsinë maqedone. Një pjesë e formacioneve çetnike të lidhura me politikën e Sofjes, ose grupime e individë që aspironin për një Maqedoni të pavarur, i kthyen armët kundër ushtrisë serbe dhe u afruan me forcat shqiptare të rezistencës, me qëllimin e përbashkët – dëbimin e pushtuesve serbë nga viset përkatëse shqiptare e maqedone.¹⁴

Dhunë mbi shqiptarët nuk ushtronte vetëm ushtria dhe bandat çetnike. Përmes legjislacionit specifik dhe mënyrës së programuar ose spontane të zbatimit të tij, dhunë ushtronte gjithë administrata që organizoi Serbia në viset e pushtuara. Qoftë pushteti fillestar ushtarak i vendosur dora-dorës në viset që okupoheshin, qoftë ai i dekretuar më 27 dhjetor 1912 nga mbreti “Mbi vendosjen e pushtetit ushtarak në viset e çliruara”,¹⁵ gjithnjë me tiparet e një administrate koloniale të tipit më të egër ushtarak-policor, asnjëherë realisht nuk e ndalën dhunën mbi popullsinë shqiptare (dhe që nga 29 qershori i 1913-ës edhe mbi atë maqedone që prirëj drejt politikës bullgare ose pavarësisë). Duke operuar me dekretligjet “Për sigurinë publike”, apo

¹³ Th. Murzaku, *vep. e përm.*; Sh.Braha, *vep. e përm.*; Shih edhe: *AIH. Raportet konsullore për MPJ të Vjenës, viti 1913 (HHSItA,PA,A)*; etj.

¹⁴ *Po aty*; Shih edhe: H.J. Vasiljeviq, *Çetnička akcija u staroj Srbiji i Makedoniju*, Beograd, 1928; A. Apostolov, *Kolonizacija u Makedonija vo stara Jugoslavija*, Skopje, 1966; etj. Shih pozicionet e krerëve çetnikë Vasilie Tërbiq etj., dhe Jovan Babunski etj., si edhe veprimtarinë e vërhovistëve P. Çaulev etj., apo nacionalistëve majtistë maqedonas si J. Sandanski etj., gjatë zhvillimeve të shtatorit të vitit 1913.

¹⁵ G. Todorovski, *Makedonija po Balkanskite vojni 1912-1913*, Skopje, 1981, f.27-28; H. Purellku, *art. i përm.*, në “Jehona”, nr.4, Shkup, 1992, f.109.

“Ligjin mbi internimet” të 18 gushtit 1913,¹⁶ dhe me urdhëresa të ndryshme, autoritetet serbe të pushtimit, krahas terrorizimit të popullsisë dhe rrënimit e grabitjes së vendbanimeve shqiptare, kishin argumente ligjore për të justifikuar *internimet* dhe *presionet* për t’i detyruar shqiptarët të kërkonin pranë forumeve ndërkombëtarë që viset e tyre të përfshiheshin në Serbi (kur në Londër ende diskutohej për kufijtë)¹⁷ mandej për të *justifikuar vendosjen e tatimeve të rënda* e për të shtuar tatime të jashtëzakonshme, për të *rekuizuar* “për nevojat e luftës” pasuritë e shqiptarëve, gjithashtu *për të rënduar me angari* të papërballueshme popullsinë në ndërtime strategjike (rrugë, ura, transhe etj.) dhe madje për të *rekrutuar* meshkujt e për t’i përdorur ata në front kundër ushtrisë bullgare. Dhuna shkoi deri në *bllokimin e shitblerjes* së tokës në dëm të shqiptarëve, si edhe në *grabitjen e tokave dhe të shtëpive* të tyre. Me qëllim të dyfishtë autoritetet serbe nxitën gjithashtu popullsinë maqedone që të mos respektonte marrëdhëniet e mëparshme të pronësisë dhe detyrimet ndaj pronarëve shqiptarë, si edhe të vinte dorë në tokat dhe pronat e tjera të tyre.¹⁸ Përmes shpronësimit agrar të shqiptarëve dhe likuidimit ose shpërnguljes së tyre, si edhe krijimit të klimës armiqësore midis tyre dhe maqedonëve, autoritetet serbe synonin të kishin nën kontroll situatën në këto vise dhe njëherësh t’i hapnin rrugë procesit të kolonizimit, që përfundimisht do të duhej të ndryshonte strukturën etnike të viseve shqiptare.

Të kapluar nga ethet patologjike për të aneksuar sa më tepër vise shqiptare, qarqet drejtuese të Beogradit, edhe pas caktimit në vija të përgjithshme të kufirit verior dhe lindor të Shqipërisë, më 22 mars 1913 në Londër, apo pas 29 korrikut 1913, kur Konferenca e Ambasadorëve përfundimisht njohu pavarësinë e Shqipërisë, përsëri nuk i ndërpreu veprimet e dhunshme ndaj shqiptarëve (e afërmendësh veprimet e llojllojshme kundër shtetit të brishtë të porsalindur shqiptar), me synimin që, duke shfrytëzuar periudhën e turbullt dhe gjendjen e luftës, gjithnjë prezente në Ballkan, të rënonin në masë elementin shqiptar (afërmendësh me plan të mëtejshëm të shembnin e copëtonin tërësisht, ose të vinin në kontrollin e tyre Shqipërinë e njohur nga Londra). Në këtë kuadër mjafton të përmendet se vetëm në dimrin e vitit 1912-1913 nga viset midis Dibrës dhe Strugës, në

¹⁶ F. Shabani, *vep. e përm.*, f.134 citon “Makedonski Gllaz”, nr.7, Peterburg, 4 nëntor 1913.

¹⁷ L. Rushiti, *vep. e përm.*, f.94.

¹⁸ *Po aty*; Shih edhe: A. Apostolov, *vep. e përm.*; M. Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë 1918-1941*, Tiranë, 1992; Th. Murzaku, *vep. e përm.*, f.213; *Srpski izvori za istorijata na makedonskot narod 1912-1914*, Izbor redakcija i komentar G. Todorovski, Skopje, 1979, f.101; etj.

periferitë e Vlorës dergjeshin rreth 20 mijë muhaxhirë.¹⁹ Pas vendosjes së paqes me Turqinë, më 30 maj 1913, një lumë prej dhjetëra mijëra të ikurish nga viset e ndryshme shqiptare lindore u shpërngulën drejt Anadollit.²⁰ Kjo ishte një humbje kolosale njerëzore po të llogaritet se në prag të Luftës së Parë Botërore në trevat shqiptare lindore jetonin rreth 200-250 mijë shqiptarë.²¹

Presioni ishte i dukshëm, madje edhe në viset që me vendimin e 22 marsit 1913 të Londrës i mbeteshin Shqipërisë por që, duke u justifikuar me “arsye strategjike të sigurisë”, Serbia vazhdoi edhe për një kohë të shkurtër t’i mbante të pushtuara. Banorët e këtyre viseve përveç që *nxiteshin* me çdo mënyrë të kërkonin bashkim me Serbinë,²² pasi trupat serbe u detyruan të tërhiqen nën presionin e Fuqive të Mëdha, në kundërshtim me vendimet e këtyre fuqive, *i izoloj*, duke u ndaluar të zbrisnin në tregjet e tyre tradicionale si Dibra, Tetova, Struga dhe, në veri, Prizreni e Gjakova.²³

Të mbipopulluara nga dyndja e mijëra muhaxhirëve, përballë alternativës për të “vdekur nga uria ose nga plumbi”, sikurse shprehej socialdemokrati i njohur serb Dimitër Tucoviqi,²⁴ por edhe nga pamundësia për të duruar më tej “brutalitetin serb”, sikurse shprehej ministri i Jashtëm i Austro-Hungarisë, Berhtoldi në telegramin dërguar përfaqësive austro-hungareze nëpër Europë,²⁵ popullsia e këtyre viseve shpërtheu mbi pushtuesit duke krijuar epiqendrën e kryengritjes së fuqishme të 1913-ës. Natyrisht në organizimin e saj luajtën rolin e vet atdhetarë të njohur si Elez Isufi, Isa Boletini, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Mehmet Dërhalla etj., në

¹⁹ *Dokumenti o spolnoj politici ... burim i përm.*, Knjiga VI, Beograd, 1986, f.262; Shih edhe: F. Shabani, *vep. e përm.*, f.227.

²⁰ P. Stojanov, *vep. e përm.*, Skopje, 1969, f.192.

²¹ *Srpski izvori...*, *burim i përm.*, Skopje, 1979, dok.nr.3, 7, 21, 25, 39, 42; Shih edhe: H. Purellku, *art. i përm.*, në “Jehona”, nr.4, 1992, f.111; *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar*, (Përmbledhje dokumentash), vëll.I, Tiranë, 1975, dok.nr.129; Z. Cana, *Social-demokracia serbe dhe çështja shqiptare 1903-1914*, Prishtinë, 1986, f.189.

²² Th. Murzaku, *vep. e përm.*, f.29; B. Hrabak, *Arbanashki upadi i pobune na Kosovu i u Makedonije od kraja 1912 do kraja 1915 godine*, Vranje, 1988, f.35; H. Purellku, *art. i përm.*, në “Jehona”, nr.4, 1992, f.123.

²³ *AIH. HHStA,PA.A. Raport nga legata e Austro-Hungarisë në Beograd, 13 shtator 1913*, nr.8618.

²⁴ Z. Cana, *vep. e përm.*, Prishtinë, 1983, f.130.

²⁵ *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj* (Përmbledhje dokumentesh), Tiranë, 1963, dok.nr.322, 15 tetor 1913; Shih edhe: K. Prifti, *Kryengritja e shtatorit të vitit 1913 dhe çështja e bashkimit kombëtar të shqiptarëve*, në “Jehona”, nr.6, Shkup, 1993, f.12.

bashkëpunim me parinë e vendit, si edhe qeveria e Vlorës,²⁶ që e përcollën me dhimbje, krahas vendimit të Londrës të 22 marsit 1913 për kufijtë, edhe aktin provokues të aneksimit të Kosovës dhe të viseve shqiptare lindore, që Serbia shpalli më 7 ose 8 shtator 1913.²⁷

Elita politike shqiptare e kohës llogariste se popullsia e zonave ku u caktuan kufijtë e rinj, e pranishme në Lëvizjen Kombëtare qysh në fillimet e kësaj, aktive në luftimet mbrojtëse gjatë Luftës Ballkanike, madje e pranishme dukshëm edhe në Kuvendin e Vlorës dhe në qeverinë e dalë prej tij (Vehbi Dibra – Agolli u zgjodh kryetar i Pleqësisë, Mehmet Dërhalla ministër i Mbrojtjes), tashmë e vënë në pozitë shumë të vështirë, nuk mund të duronte më gjatë dhunën serbe. Nga ana tjetër edhe momenti apo koniunkturat rajonale, gjithashtu gjykoreshin të volitshme, sepse pas humbjes së pësuar në Luftën e Dytë Ballkanike, Bullgaria do të ishte një aleate potenciale në rastin e përplasjes shqiptaro-serbe. Tjetër punë që shpërthimi dhe zhvillimi i kryengritjes vërtetoi se ajo kishte nisur në kushte të disfavorshme* ...

Pavarësisht nga arsyetimet, se ku u gabua ose çfarë solli dështimin, një gjë duket e padyshimtë. Shqiptarët në situatën që u ishte imponuar nuk mund të duronin më tej. Se cili ishte faktori kryesor që shpërtheu kryengritja mendoj se del qartë edhe në thirrjen e popullsisë së Dibrës drejtuar Fuqive të Mëdha, më 15 tetor 1913, pak ditë pas shtypjes së kryengritjes. Në këtë thirrje ndër të tjera theksohej: "... pasi duruam për dhjetë muaj zgjedhën e serbëve, ndjekjet e fundit na çuan në kaq dëshpërim sa të pëlqejmë vdekjen në vend të robërisë".²⁸ Është e qartë se Kryengritja e shtatorit të 1913-ës nuk ishte një rufe në qiell të pastër. Për muaj me radhë dhuna e terrori dhe

²⁶ K. Prifti, *art. i për.*, në "Jehona", nr.6, 1993. I. Qemali në një fjalim në tetor 1913 deklaroi se "ishte detyrë e Qeverisë të përpiquej të mos mbetej asnjë shqiptar jashtë Shqipërisë. Por, pohonte ai, fatkeqësisht nuk ishim të përgatitur për këtë". Kurse L. Gurakuqi, në cilësinë e ministrit të Qeverisë së Vlorës, në intervistën e dhënë në Europë, qysh në korrik 1913 do të theksonte se shqiptarëve për zgjidhjen e çështjes së tyre kombëtare do t'u duhej edhe në të ardhmen të përdornin armët. "Buçima e armëve, deklaronte ai, arrin më shpejt në veshët e Europës. Do t'i përdorim sa herë që të gjykojmë se veshi i Europës është i shurdhët, që të na dëgjojë zërin, i cili nuk do të pushojë të kërkojë drejtësi".

²⁷ G. Todorovski, *vep. e për.*, Skopje, 1981, dok.nr.17.

* A kishte gisht në krijimin e minuseve për kryengritjen Esat Toptani, përmes besnikëve të tij në viset e Dibrës? (Dihet se redifët dibranë kishin luftuar nën komandën e tij për mbrojtjen e Shkorës, më pas ishin ndjekur nga regjimi serb i pushtimit, por 3 vjet më vonë, rreth 500 dibranë do të luftonin në Frontin e Selanikut përkrah trupave serbe për llogari të Esat Pashës). Ende duhet hulumtuar për t'i dhënë përgjigje të saktë kësaj pyetjeje.

²⁸ *Qeveria e përkohshme e Vlorës...*, *burim i për.*, dok.322.

përgjithësisht politika koloniale thellësisht antishqiptare e të gjithë strukturave ushtarake e civile serbe, kishin prodhuar një *qëndresë* permanente, të formave dhe përmasave të ndryshme, ku të organizuar e ku spontane, si një reagim të natyrshëm mbrojtës.²⁹ Pa u zgjatur, le të përmendim se forma më e lartë e qëndresës, rezistenca me armë e çetave dhe individëve, shpesh në nivele të organizimeve nga struktura politike, nuk rreshti asnjë ditë që nga çasti i parë i depërtimit të trupave serbe në këto vise. Le të përmendim Mbledhjen e Shkupit të 14 shtatorit 1912, betejën në luginën e Drinit në rajonin Dibër-Lumë në 13-15 nëntor 1912, goditje të çetave të armatosura shqiptare në pranverë-verën e vitit 1913 etj.³⁰ Madje, edhe pas shtypjes së kësaj kryengritjeje, deri në shembjen e pushtetit serb në dimrin e viteve 1915-1916, qëndresa nuk u ndërpre.³¹

Në historiografi ende diskutohet nga këndvështrime të ndryshme, nëse qëndresa shqiptare në vitet 1912-1913 ishte pasojë apo shkak i raprezaljeve dhe dhunës serbe. Duke qëndruar në krahun që ka pikëpamjen se qëndresa ishte pasojë e pushtimit, e dhunës dhe terrorit të pushtuesit, do të përmendja vetëm një argument, pikërisht faktin se nuk ishin shqiptarët që hynë në tokat serbe, por ndodhi e kundërta.

Të pabindurit ndaj regjimit të pushtuesit, ata që gjetën forcë të sfidonin dhunën, ata që edhe pse ishin të detyruar të largoheshin nga vendbanimet në vend të shpërnguljes pa kthim, gjetën kurajën për t'u rikthyer sërish në viset e veta, gjithashtu të arratisurit dhe kaçakët që me armë guxonin të kundërshtonin arbitraritetin e pushtetit të huaj, mandej propaganduesit e nevojës për rezistencë dhe organizatorët e saj, etj., etj., të gjithë pa përjashtim, në një mënyrë ose në një tjetër, në një dimension ose në një tjetër, ishin mesazhierë të idesë së domosdoshmërisë për të mbijetuar, mesazhierë të shpresës për ditë më të mira, mesazhierë të idesë së çlirimit dhe bashkimit kombëtar. Falë tyre dhe të tjerëve, në vise të tjera, që punuan e luftuan për të përballuar sfidat e kohërave, populli e kombi shqiptar arriti të mbijetojë dhe të hyjë në këtë shekull të ri me arritje impresionuese. Jam i bindur se ai ka forca për të shkuar më tej në synimin e tij për të zënë një vend dinjitoz midis kombeve të Evropës.

Duke përkujtuar 90-vjetorin e Kryengritjes së vitit 1913, kësaj ngjarjeje të shënuar në historinë tonë kombëtare, ne kemi rastin jo vetëm të tregojmë

²⁹ *Dokumenti o spolnoj politici..., burim i përm.* Telegrame të Mishiqit nga Shkupi për qeverinë dhe i Pashiqit për përfaqësuesin serb në Petrograd, gusht 1913, f.294-295; *Srpski izvori..., burim i përm.*, Skopje, 1981, dok.nr.8, 17; Xh. Shala, *vep. e përm.*, Prishtinë, 1990, f.149.

³⁰ *Po aty*; Shih edhe: Th. Murzaku, *vep. e përm.*; Sh. Braha, *Beteja e Drinit kundër agresionit serb*, Tiranë, 1992, etj.

³¹ *Po aty*.

nderimin e respektin për paraardhësit tanë dhe sakrificat e tyre në mbrojtje të jetës e të nderit, të familjes e të atdheut, por edhe të orientohemi nga mesazhet e vyera, të cilat na mësojnë të konceptojmë drejt rrugën drejt të ardhmes në një botë që ka shpallur për simbole të vetat idealet e barazisë, lirisë, bashkëpunimit dhe respektimit mbarënjëzëzor.

Prof. Dr. Marenglen VERLI

SITUATION IN OCCUPIED EASTERN ALBANIAN AREAS
AND ANTI-SERB RESISTANCE
(October 1912 – September 1913)

Summary

Remembering the 90th anniversary of 1913 Uprising, this marked event in our national history, we have an opportunity to not only show our reverence and respect to our predecessors and their sacrifices in defending life and honor, family and fatherland, but also be able to orientate by their valuable messages that teach us to properly contemplate on the road we have to take towards the future in a world that has declared its symbols as being ideals of equality, liberty, cooperation and all-human respect.